

SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Bashkia e Elbasanit shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës:

- *Infermier, Shtëpia e të Moshuarve, në Drejtorinë e Shërbimeve për Moshën e Tretë dhe PAK, pranë Agjencisë së Shërbimeve Sociale;*

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
3. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në degën e Infermierisë;
4. Të jetë i pajisur me lincensën për ushtrimin e profesionit të infermierit;
5. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
6. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1) Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- 2) Curriculum Vitae;
- 3) Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- 4) Çertifikatë e përbërjes familjare;
- 5) Fotokopje të diplomës së shkollës;
- 6) Fotokopje të Licencës së Infermierit;
- 7) Fotokopje e librezës së punës;
- 8) Raport mjeko-ligjor;
- 9) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- 10) Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm);

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit, pranë zyrës së informacionit, Bashkia Elbasan